



Shkolla Verore Sindikale - ITUC PERC

Prishtinë 29 shtator 2011 - Kryetari i BSPK-së Haxhi Arifi dhe Dafina Mehaj zyrtare për Marrëdhënie Ndërkombëtare, morën pjesë në Shkollën e IV-të, Verore Sindikale- ITUC- PERC të mbajtur me 21-23 shtator në Sofje, Bullgari. Ndër temat kryesore të diskutuara ishin: Kriza ekonomike dhe dimensionin social, opsionet e sindikatave; Përgjigjet sindikale ndaj rënies politike dhe ligjore të politikave të ashpra; Politikat sindikale ndaj natyrës së jo barazisë në pikëpamje të drejtave sociale dhe marrëdhënies industriale; Fuqizimi i procesit demokratik përmes angazhimit sindikal; Korniza e plan programit të PERC-ut, për vitin 2011-2015 dhe vendosja e një grupi punues i cili do ta përgatisë një draft për Këshillin e Përgjithshëm të PERC-ut. Sekretarja e përgjithshme e ITUC-ut Sharan Burrow, në fjalimin e saj diskutoi për krizën globale, dhe u bëri thirrje sindikatave që të mos ndalen në luftën për drejtësi sociale të gjithë punëtorëve. Fjalim mbajtën edhe dy kryetarët e sindikatave bullgare z. Konstantin Trenchev nga Podkrepa dhe Plamen Dimitrov nga CITUB, si dhe z. Dan Cunniah, drejtor i ILO Actrav, Dimitrina Dimitrova përfaqësuese e ILO për Evropë etj. Përfaqësues të shteteve të ndryshme gjatë fjalimeve të tyre potencuan që armik kryesor i sindikalistëve është Qeveria, e cila po krijon papunësi për shkak të politikave të gabuara dhe se fajin e tyre, tani po e paguan klasa punëtore.



ITUC-u në bashkëpunim me Sekretariatit e PERC-ut, kanë mbajtur po ashtu edhe takimin e tretë dyditor të Rrjetit HTUR-ë (Të drejtat njerzore dhe ato sindikale) të PERC-ut. Qëllim i i organizimit të këtij takimi ishte zhvillimi i kapaciteteve regjionale, analizimi i punës së HTUR/PERC që nga takimi i fundit i mbajtur në Shtator 2010, në Bukuresht. Gjithashtu, temë diskutimi ishin qështjet madhore të shkeljeve të të drejtave sindikale dhe atyre të njeriut, hartimi i Planit të Veprimit për vitin 2012, si dhe të sigurojë pjesëmarrje më efektive të organizatave sindikale në aktivitetet e HTUR-it. Departamenti për te Drejta Themelore Njerëzore HTUR ne krye me z. Stephen Benedict -drejtor shprehen brengosjen e tyre në lidhje me këtë rrjet, ku anëtarë janë 90 shtete nga ITUC /PERC dhe se ne rast të ndonjë fushate ose shkelje të të drejtave njerëzore nëpër botë duhet te reagohej nga të gjithë. Ata kërkuan nga të pranishmit që të shqyrtojnë mire punën e këtij rrjeti dhe te analizojnë se a është i nevojshëm vazhdimi i rrjetit dhe nëse po atëherë kërkohet angazhim me i madh i shteteve pra mos te presin vetëm nga Brukseli shkresa por te punojnë te gjithë ne këtë drejtim dhe te jene bashkë pjesëmarrës në të gjitha aktivitetet e rrjetit si dhe te prezantojnë raste të ndryshme të shkeljeve të të drejtave njerëzore në

mënyrë që të publikohen në librin e këtij rrjeti i cili publikohet çdo vit nga ITUC/HTUR. Kishte pasur kritika dhe thirrje sidomos për shtetet e Ballkanit të cilat funksionojnë më ndryshe se shtetet evropiane dhe u kërkua nga ata që të mandatojnë stafin e tyre dhe të kenë më shumë kompetenca punëtorët që të punojnë në këtë rrjet, d.m.th ai i cili është përfaqësues i organizatës për këtë rrjet të jetë përgjegjës dhe jo gjithmonë përmes kryetareve sepse kjo e pamundëson punën efektive. Andaj u bë thirrje që të lejojnë stafin e organizatave të tyre të angazhohen me shume dhe të bëjnë punë të pavarur nga udhëheqësja politike si dhe të hulumtojnë raste dhe ti paraqesin këto në Bruksel në HTUR sa më shpejt të jete e mundur në mënyrë që të arrihen rezultate me të mira. Në takimin e tretë dyditor të Rrjetit HTUR-ë diskutuan këto tema:

1. Analizimi i punës së aktiviteteve të ITUC-HTUR për vitet 2010 - 2011,
2. Analizimi i punës së aktiviteteve të ndërmarra nga Rrjeti PERC-HTUR për vitet 2010 – 2011, të arriturat dhe vështirësitë me të cilat është ballafaquar,
 - Konferenca e Moskës, Dhjetor 2010,
 - Takimi i ILC në Bruksel, Mars 2011,
 - Konferenca e ILO, Qershor 2011,
 - Anketa vjetore e ITUC, Qershor 2011,
 - Kampanja në Gjeorgji,
 - Veprimet solidare në mes Sindikatave.
3. Të rehat legjislative në regjionin e PERC-ut ,
4. Zhvillimi dhe zgjerimi i Rrjetit PERC/HTUR,
5. Miratimi i Planit të Punës të PERC/HTUR, i cili u prezantua para pjesëmarrësve të Shkollës Verore të PERC-ut.

Pasuan diskutimet nga te pranishmit ku u tha se gjithsesi puna e rrjetit HTUR duhet të vazhdojë dhe se është punë mjaft e vlefshme që behet për sindikatat dhe publikimet që dalin për çdo vit si përmbledhje e këtij rrjeti janë informata mjaft të rëndësishme për aktivitetet sindikale. Po ashtu u mbajt edhe një prezantim i një libri nga z. David Coats, këshilltar i çështjeve të punës i cili e prezantoi librin e publikuar nga Instituti Ekonomik Social – ESI lidhur me krizën ekonomike, dimensionin social dhe opsionet sindikale. Ai mes tjerash tha se shtetet të cilat kanë sindikata më të fuqishme kanë ekonomi me të zhvilluar dhe e kundërta d.m.th shtetet të cilat kanë sindikata të dobëta nuk kanë ekonomi të zhvilluar, pra sipas studimeve këto shkojnë bashke dhe duhet të jenë fleksibile sepse nuk ka tjetër rrugë. U tha se tregjet e punës janë shërbëtore të mire, por udhëheqës të këqinj. U diskutua edhe plan programi i punës së PERC për vitin 2011-2015 i cili do të shtjellohet edhe në Asamblenë e Përgjithshme të PERC. Në fund të takimit u hartua një Deklaratë Mbështetëse për punëtorët e Gjeorgjisë, të cilët janë në kushte të vështira pune (3 prej tyre janë burgosur), e cila deklarata do të prezantohet para Shkollës Verore Sindikale të PERC-ut për miratim.

**Zyra për Informim, BSPK
Fatma Rastelica**

